

VENDIM
Nr. 18, datë 9.1.2013

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 707, DATË 25.8.2010 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I LINJËS
400 KV, TIRANË – PODGORICË, QARKU TIRANË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 707, datë 25.8.2010 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në lekë, në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse të kompensimit, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqe totale prej 9372.35 (nëntë mijë e treqind e shtatëdhjetë e dy pikë tridhjetë e pesë) m², tokë bujqësore, shtëpi, arë dhe ullishte, vlerësuar në shumën e përgjithshme prej 139 053 152 (njëqind e tridhjetë e nëntë milionë e pesëdhjetë e tre mijë e njëqind e pesëdhjetë e dy) lekë.”.

2. Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. Fondi prej 139 053 152 (njëqind e tridhjetë e nëntë milionë e pesëdhjetë e tre mijë e njëqind e pesëdhjetë e dy) lekësh të përballohet nga fondet e OST sh.a.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

N/r	OBJEKTI	Pronesia											Shenime	
		Emri	Atesia	Mbiemri	Lloji i pasurise	Nr. Kadastral	Nr. pasurise	Nr i shlylles	Sasia per shpronesim definitiv m2	cmimi shilfe ZRRP/lek/ m2	Vlera e kompesimit	Vlera totale e kompesimit ne lekë		Adresa e Pronarit
1	LTL 400	Arben	Xhemal	Mesiti	shtëpi	2066	40/79	301-302	17	30,800.0	523600.0	523600.0	Kamez	me certificate pronesie
2	LTL 401	Eshref	Galip	Baloshi	shtëpi	2372	240/39	311-312	4	30800.0	123200.0	123200.0	Kamez	me certificate pronesie
Totali									21.0		646 800			